



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 22.6.2022

Lënda: Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 22.6.2022, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 393/2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Gerd Hoxha

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Komisioneri Publik, bazuar në kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, në konsideratë edhe të Rekomandimit të ONM-së, pasi vlerësoi se vendimi nr. 393/2021, i Komisionit, është i cenueshëm në tërësinë e tij, nëpërmjet ankimit, shtroi për diskutim dhe vlerësim, para juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit, një sërë çështjesh lidhur me kriterin e pasurisë dhe atë profesional.

Shqyrtimi i çështjes objekt ankimi dhe debati gjyqësor i palëve u ndal më së shumti në nevojën për kontrollin e bazueshmërisë së vendimit nr. 393/2021, në drejtim të hetimit të mëtejshëm të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe interesave private të tij, të personave të lidhur, të personave të tjerë të lidhur me të, si dhe në nevojën për kryerjen e një analize të re financiare, me qëllim justifikimin bindshëm të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e pasurive të deklaruara, me të ardhura të ligjshme, sipas përcaktimit të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 84/2016.

Në funksion të shqyrtimit gjyqësor, Kolegji, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, si dhe Opinionit të paraqitur të ONM-së për bashkimin e çështjeve objekt ankimi, të subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortes së tij, vendosi të ndërmarrë disa veprime procedurale, si lejimin e çeljes së hetimit gjyqësor, marrjen në cilësinë e provës të akteve përkatëse, si dhe përgatitjen e një analize

paraprake ekonomike-financiare për subjektin e rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur me të, analizë financiare, e cila iu nënshtrua debatit gjyqësor¹.

Komisioneri Publik, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, duke i qëndruar shkaqeve të ankimit, si dhe parashtrimeve me shkrim të paraqitura në seancat gjyqësore të zhvilluara në kuadër të këtij gjykimi, vlerëson se:

I. Për sa i përket kontrollit të kriterit të pasurisë

1. Në lidhje me shkaqet e ankimit për pasurinë *“Apartament me sipërfaqe 125 m²”*, në vlerën 6.500.000 lekë, ndodhur në Tiranë, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, ish-bashkëshortes së tij, Komisioneri Publik konstaton se rrethanat e faktit, në përfundim të këtij gjykimi, mbetën të njëjta, dhe si të tilla, interpretimi ligjor mbi to, prej palëve pjesëmarrëse në këtë proces, mbetet për t’u çmuar dhe vendosur nga ana e Kolegjit.

1.1 Si shkaqe ankimi për këtë pasuri, paraqitëm: (i) nevojën për kryerjen e një analizë të re financiare nga ana e Kolegjit mbi vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të deklaruara *“Kursimet personale ndër vite”*, për pagesën e kështit të parë të pasurisë, duke qenë se për kursimet e deklaruara nga të ardhurat nga punësimi në sektorin privat, gjatë viteve 1995-2000, nuk provohet pagimi i detyrimeve tatimore, duke mos plotësuar kështu kriteret e përcaktuara nga neni D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme; si dhe (ii) vlerësimin e mundësisë financiare të prindërve të personit të lidhur, duke rivlerësuar të gjitha burimet e deklaruara dhe të pretenduara, për të krijuar shumën prej 25.000 euro, deri në shkurt 2011, dhënë hua personit të lidhur. Kjo shumë rezulton se ka shërbyer për shlyerjen e kredisë bankare, marrë nga personi i lidhur, në mars 2009, me qëllim rikonstrukcionin e apartamentit, kredi në të cilën subjekti i rivlerësimit rezulton në cilësinë e dorëzanësit financiar.

1.2 Për qëllim të shqyrtimit gjyqësor të këtyre shkaqeve, Kolegji hartoi analizën paraprake financiare, nga e cila rezultoi se, për sa i përket burimit të deklaruar *“Kursime personale ndër vite”*, mbulohet me burime të ligjshme pagesa e shumës 1.500.000 lekë, për kështin e parë të apartamentit në vitin 2011, por kursimet *cash* të deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003, në shumën 2.500.000 lekë, nuk mbulohen me burime të ligjshme për një diferencë negative prej **-1.281.804 lekë**.

1.3 Lidhur me mundësinë e prindërve të personit të lidhur për të dhënë hua në shumën 25.000 euro, nga analiza paraprake financiare e Kolegjit, bazuar në shkaqet e ankimit, rezultoi se për periudhën e marrë në analizë, 2005 - janar 2011, prindërit e ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nuk kanë pasur mundësi që, me të ardhura të ligjshme, të kursenin dhe të jepnin hua shumën 25.000 euro, për një pamjaftueshmëri financiare në shumën – **16.857 euro**.

¹ Analiza paraprake është njoftuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, më datë 20.4.2022, me anë të shkresës përcjellëse me nr. 40/43 regj. (JR).

1.4 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, të paraqitura në seancën e datës 9.6.2022, ndër të tjera, pretendoi se për nënçështjen e parë: (i) *shuma prej 1.500.000 lekë, nuk është pjesë vetëm e kursimeve të mia, të akumuluar deri në vitin 2003, por është pjesë e “kursimeve të mia ndër vite”, d.m.th., deri në momentin e pagesës më dt. **.2.2011... dhe provohet se unë kam pasur burime më se të mjaftueshme dhe të ligjshme, për të paguar më datë **.2.2011, këstin e parë,... edhe në rast se nuk përfshihet në analizë shuma prej 1.500.000 lekë, e fituar prej meje në sektorin privat në periudhën 1995-2000.* Ndërsa për nënçështjen e dytë: (ii), ndër të tjera, subjekti pretendoi se ... *në cilësinë e subjektit të rivlerësimit nuk kam detyrimin të justifikoj ligjshmërinë e burimit të shumës 25.000 euro, të marrë nga znj. *** te prindërit e saj, pasi: a) huaja nuk është marrë prej meje; b) nuk është marrë gjatë martesës; dhe c) nuk ka shërbyer si burim për krijimin e apartamentit të blerë nga unë dhe ish-bashkëshortja në Tiranë.* Subjekti pretendoi se analiza paraprake financiare e kryer nga Kolegji ka të meta dhe mospërputhje me standardin e përdorur në jurisprudencën e Kolegjit, pasi shpenzimet e familjes ***, të përbërë nga dy pensionistë, janë vendosur 2-3 herë më të larta se standardi i shpenzimeve të jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së.

1.5 Komisioneri Publik, në vlerësim të analizës paraprake financiare të Kolegjit, provave të administruara dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, paraqitur në seancën e datës 9.6.2022, vlerëson se kursimet *cash* të deklaruara prej subjektit deri në fund të vitit 2010, janë të mjaftueshme për pagesën e shumës 1.500.000 lekë. Por mbeten të pambuluara me burime të ligjshme kursimet e deklaruara në deklaratën e parë të tij, DV-2003, në shumën 2.500.000 lekë, pasi nga aktet në dosje, rezulton se të ardhurat e ligjshme për të cilat është provuar pagesa e detyrimeve tatimore në përputhje me nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, janë në vlerën 1.226.026 lekë (referohuni pasqyrës nr. 1.1, f. 4, të analizës paraprake të Kolegjit). Bazuar në këto të ardhura, rezulton se kursimet e deklaruara në DV – 2003 nuk mbulohen me burime të ligjshme për një diferencë negative prej – **1.281.804 lekë**, diferencë që reflektohet në pamundësinë e mbulimit me burime të ligjshme të pasurisë nr. 2, apartamentit të ndodhur Vlorë, sikundër do të trajtohet në vijim.

1.5.1 Për sa i përket pretendimeve të subjektit mbi mungesën e detyrimit ligjor për të justifikuar *ligjshmërinë e burimit të shumës 25.000 euro, të prindërve të personit të lidhur*, Komisioneri Publik, bazuar në aktet e administruara, vlerëson të ritheksojë se kjo hua ka shërbyer për shlyerjen e kredisë bankare, marrë nga personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit, pranë një banke të nivelit të dytë në vitin 2009, në të cilin vetë subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e dorëzanësit financiar, marrëdhënie kjo e deklaruar prej tij në DV- 2009 (f. 5). Nisur edhe nga fakti se kredia e marrë nga personi i lidhur ka pasur si qëllim rikonstruksionin dhe mobilimin e pasurisë *Apartament*, blerë në vitin 2012, nga subjekti i rivlerësimit, vlerësohet i pabazuar ky pretendim i subjektit.

1.5.2 Për sa i përket burimeve të ligjshme të prindërve të personit të lidhur, për të dhënë hua këtë shumë, sikundër pasqyruar dhe në tabelën nr. 2 të analizës paraprake financiare, të kryer nga Kolegji, rezulton se të ardhurat e prindërve të personit të lidhur janë të pamjaftueshme për të

mbuluar shpenzimet e jetesës së periudhës së analizuar, huan e dhënë dhe kursimet e evidentuara në llogaritë bankare. Edhe në konsideratë të llogaritjes së shpenzimeve të jetesës së familjes ***, vetëm në masën e ndihmës mujore të deklaruar dhënë nga e motra, znj. ***.***, edhe pse kjo e fundit mbetet deklarative, përsëri do të rezultonte se huaja e dhënë nuk do të mbulohej plotësisht me burime të ligjshme².

2. Në lidhje me pasurinë “Apartament banimi me sip. 126,5 m²”, ndodhur në Vlorë, në bashkëpronësi me ish-bashkëshorten, blerë për shumën 55.452 euro, si shkak ankimi, paraqitëm nevojën e rivlerësimit të zërave përbërës të analizës financiare dhe mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortes së tij, për të justifikuar “kursimet e deklaruara ndërvite” të përdorura si burim për blerjen e kësaj pasurie.

2.1 Nga analiza paraprake financiare e Kolegjit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme blerjen e pasurisë për një diferencë negative prej – 5.971.505,59 lekë.

2.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij të paraqitura në seancën e datës 9.6.2022, ndër të tjera, pretendoi se në analizë nuk janë konsideruar të paktën disa kategori të kursimeve cash ndër vite, duke prapësuar dhe analizuar të gjithë zërat financiarë, që përbëjnë shumën e përdorur prej subjektit dhe ish-bashkëshortes së tij për blerjen e apartamentit në Vlorë³. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi dhe prapësoi në seancë, analizën e Kolegjit lidhur me: (i) ligjshmërinë dhe përfshirjen në analizë të shumës 1.500.000 lekë, si të ardhura të përfituara nga puna me kohë të pjesshme gjatë periudhës 1995-2000; (ii) kursimet cash të vitit 2011 nga shitja e automjetit, në shumën 1.200.000 lekë; (iii) mënyrën e deklarimit të kursimeve cash të ish-bashkëshortes dhe përfshirjen e tyre në analizë financiare (për periudhën 2006-2010); si dhe (iv) ligjshmërinë e krijimit të kursimeve në shumën 5.000.000 lekë, deklaruar nga ish-bashkëshortja, në deklaratën e vitit 2004.

2.3 Komisioneri Publik, për sa më sipër, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e shkaqeve të ankimit, pasi në vlerësim të analizës paraprake financiare, provave të administruara dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me shkaqet e ankimit, konstatojmë se:

2.3.1 Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti nuk paraqiti asnjë provë të re për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga puna me kohë të pjesshme gjatë periudhës 1995-2000. Si më sipër trajtuar (pika 1. 5), për kursimet e deklaruara në DV-2003, në shumën 2.500.000 lekë, u provua mbulimi me burime të ligjshme vetëm për shumën prej 1.226.026 lekë.

² Në këtë rast do të rezultonte pamjaftueshmëri financiare prej të paktën rreth - 4.280 euro, edhe pse nga aktet e paraqitura gjatë shqyrtimit në Kolegj të çështjes së personit tjetër të lidhur, rezulton se masa e pensionit suplementar të ***.*** është e ndryshme për periudhën 2005-2011, nga ajo e llogaritur në analizën paraprake të Kolegjit mbi këtë hua.

³ Për më tepër, referohuni aktit “Parashtrime përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për kundërshtimin e analizës financiare paraprake të kryer nga KPA, mbi bazën e vendimit të ndërmjetëm të dt. 5.4.2022, sipas pretendimeve të Komisionerit Publik”, f. 16-43, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 9.6.2022.

2.3.2 Në lidhje me kursimet *cash* të vitit 2011, në shumën 1.200.000 lekë, deklaruar me burim nga shitja e automjetit, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, mbeti i paprovuar pretendimi i subjektit mbi disponimin *cash* të kësaj shume në fund të vitit 2011, për sa kohë këto kursime nuk rezultojnë të deklaruara në deklaratat periodike vjetore të vitit respektiv, të cilat, në kuptim të nenit 32, pikës 5, të ligjit nr. 84/2016, kanë vlerën e provës. Ky vlerësim i Komisionerit lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe me shkaqet ankimore për pasurinë *Automjet Citroën C4*, blerë në vitin 2012 dhe shitur në vitin 2016, ku, nga analiza paraprake e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme blerjen e automjetit dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, për një diferencë negative prej – **687.222,17 lekë**.

2.3.3 Për sa i përket pretendimit të subjektit mbi mënyrën e deklarimit të kursimeve *cash* nga ana e ish-bashkëshortes dhe përfshirjen e tyre në analizë financiare (për periudhën 2006-2010), Komisioneri Publik vlerëson se, edhe duke i marrë në konsideratë këto pretendime, përsëri do të rezultonte pamjaftueshmëri në burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë në vitin 2016. Në konsideratë të pretendimit të subjektit se, në vitin 2006, personi i lidhur me të ka realizuar kursime *cash* në shumën 960.000 lekë, nga analiza financiare e këtij viti do të rezultonte se personi i lidhur nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe këto kursime në një shumë rreth - 486.000 lekë⁴.

2.3.4 Për sa i përket pretendimeve mbi kursimet e deklaruara nga personi i lidhur në deklaratën e parë në vitin 2004, Komisioneri Publik vlerëson se, nga kursimi *cash*, i deklaruar në shumën 5.000.000 lekë në DV-2004, vetëm shuma prej rreth 1.465.243⁵ lekë rezulton se mbulohet me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, duke rezultuar se kursimi i deklaruar në vitin 2004, nuk mbulohet me burime të ligjshme për një diferencë prej të paktën – 3.534.757 lekë, pamjaftueshmëri e cila do të reflektohej në burimet e ligjshme të blerjes së pasurisë *Apartament* në Vlorë, në vitin 2016.

2.3.5 Bazuar në sa më sipër trajtuar, do të rezultonte pamjaftueshmëri financiare e burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë *Apartament banimi* në Vlorë dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, për rreth – 5,4 milionë lekë, në vlerësim edhe të analizimit të deklarimeve vjetore të subjektit dhe personit të lidhur, mbi pakësimet e kursimeve *cash* në vitin 2012, si dhe marrë në konsideratë pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar mbi kursimet *cash*, të pretenduara të vitit 2006, pasi rezulton se shuma e disponuar e kursimeve *cash* për t'u përdorur për blerjen e pasurisë *Apartament banimi* në Vlorë, mbuluar me burime të ligjshme, në analizën e kryer nga Kolegji, do të ishte në vlerën rreth 1,7 milionë lekë⁶.

⁴ Ky rezultat përfitohet, edhe pse shuma e pretenduar nga subjekti nuk është në përputhje me deklarimin e bërë nga vetë personi i lidhur, e cila deklaroi se për vitin 2006 ka kursime *cash* në vlerën 810.000 lekë.

⁵ Në këtë shumë janë konsideruar: 772.790 lekë, përfituar nga Shkolla e Magjistraturës, për vitet 2002-2004; shuma prej 192.453 lekë, përfituar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; shuma 275.000 lekë, përfituar nga Universiteti “***”, në masën e deklaruar nga personi i lidhur prej 25.000 lekë/muaj për vitin 2004; shuma prej 225.000 lekë, përfituar nga Bursa e Ekselencës, për vitet 1999-2002.

⁶ Kjo shumë rezulton si shumatore aritmetike e kursimeve në *cash* të mbuluara nga burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, në vitin 2003, në vlerën 1.218.243 lekë, shtuar dhe pakësuar ndër vite sipas deklarimeve të subjektit në

2.3.6 Në përfundim për këtë pasuri, Komisioneri Publik, duke u bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit lidhur me ligjshmërinë, saktësinë, deklarimin dhe përdorimin e likuiditeteve *cash*, çmon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, ndodhen në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

3. *Në lidhje me pasurinë “Automjet tip AUDI⁷”, me targë: ***, të shtetasit ***,*** dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit, sipas kontratës së huapërdorjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.7.2011*

3.1 Për këtë pasuri paraqitëm si shkak ankimi, rivlerësimin e analizës financiare të kryer për personin tjetër të lidhur, z. ***,***, bazuar në përmbajtjen e deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.9.2020, rivlerësim për të cilin kërkua që të ardhurat e subjektit dhe motrës së tij, znj. ***,***, nuk duhen të përfshiheshin në mesin e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, z. ***,***, për blerjen e automjetit tip Audi.

3.2 Nga analiza financiare e Kolegjit, ka rezultuar se babai i subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare që të mbulonte me të ardhura nga burime të ligjshme, blerjen e pasurisë *Automjet tip Audi*, në vitin 2011 (automjet ky që ka qenë në përdorim të subjektit për rreth 7 vjet) për një diferencë negative në shumën – **4.758.469,81 lekë**.

3.3 Subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit gjyqësor, prapësoi dhe kundërshtoi këtë shkak ankimi dhe analizën paraprake financiare, duke pretenduar, ndër të tjera, se babai i tij nuk duhet konsideruar person i lidhur sipas ligjit dhe praktikës së konsoliduar të KPA-së. Subjekti pretendon se, edhe nëse babai konsiderohet si person i lidhur, në analizën paraprake financiare, me pa të drejtë, nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e tre anëtarëve të familjes, pjesë në atë kohë e trungut familjar (të ardhurat nga pagat e subjektit, nga nëntori i vitit 2003 deri në 2011, si dhe e dy motrave të tij). Subjekti pretendoi, gjithashtu, se në analizën paraprake financiare janë paraqitur në mënyrë të gabuar të ardhurat nga pagat, shpërblimet dhe pensionet e ligjshme të prindërve të tij.

3.4 Komisioneri Publik i qëndron shkaqeve të paraqitura në ankimin e datës 15.7.2021, duke vlerësuar se, për qëllim të këtij gjykimi, në referencë të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, për vlerësimin e ligjshmërisë së krijimit të kësaj pasurie, prindërit e subjektit të rivlerësimit duhet të konsiderohen në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, duke i lindur kështu subjektit të rivlerësimit detyrimi për të provuar burimin e ligjshëm të blerjes së kësaj pasurie.

3.4.1 Gjithashtu, Komisioneri Publik i qëndron shkaqeve të ankimit mbi mospërfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të kësaj pasurie, të të ardhurave të subjektit dhe motrave të tij, deri në

deklaratat periodike vjetore, si dhe kursime të ligjshme të personit të lidhur në vitin 2004, në vlerën 1.465.243 lekë shtuar dhe pakësuar ndër vite sipas deklarimeve në deklaratat periodike vjetore. Kursimet e vitit 2006 të subjektit, të pretenduara në shumën 600.000 lekë, rezultojnë se nuk mbulohen për një diferencë negative prej -99.000 lekë, ndërsa kursimet e personit të lidhur për të njëjtën periudhë, të pretenduara 960.000 lekë, rezultojnë se nuk mbulohen për një diferencë prej – 486.000 lekë. Për periudhën 2012-2015 kursimet deklarohen të përbashkëta.

⁷ Blerë në vlerën 37.000 USD dhe paguar detyrime doganore 931.091 lekë.

momentit kur janë shkëputur nga trangu familjar, bazuar në përmbajtjen e Deklaratës noteriale nr. *** rep. dhe nr. *** kol., të datës **.9.2020, dhe pretendimeve dhe deklarimeve të subjektit mbi kursimet e deklaruara deri në fund të vitit 2003, të vlerësuara këto në harmoni me provat e tjera të administruara, në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016.

3.4.2 Komisioneri Publik, në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në seancën e datës 9.6.2022, lidhur me këtë pasuri, çmon të drejtë vetëm pretendimin mbi të ardhurat nga pagat e pensionet e nënës së tij, znj. ***.***, pasi nga rishikimi i akteve rezulton se të ardhurat e saj janë në vlerën 3.675.516 lekë, duke u reflektuar ky ndryshim edhe në diferencën negative të konstatuar për blerjen e pasurisë *Automjet*, në shumën prej rreth – **4. 361.321 lekë**.

3.4.3 Përfundimisht, për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e shkaqeve të ankimit lidhur me këtë pasuri. Rivlerësimi i drejtë i fakteve dhe i rrethanave mbi burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie dhe vërtetësisë faktike të marrëdhënies juridike të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri, për qëllim të procesit të rivlerësimit, duhet parë nën kontrollin e dyfishtë, sipas nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016, e nëse eventualisht Kolegji vlerëson se nuk ndodhemi në kushtet e kësaj dispozite dhe nenit 3/14 të këtij ligji, vlerësimin e rastit sipas nenit D, pika 5, të aneksit të Kushtetutës, pasi duket se subjekti i rivlerësimit ka qenë pronari *de facto* i këtij aseti.

3.4.4 Gjykimi i këtij kërkimi duhet marrë në konsideratë, edhe nën dritën e praktikës së Kolegjit, sipas vendimit (JR) nr. 10/2022, në të cilin është arsyetuar se: [...] 15. *Pavarësisht sa më sipër arsyetuar, Kolegji, në kuadër të parashikimit në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, vlerëson se Komisioni, lidhur me pasuritë në përdorim të subjekteve të rivlerësimit ka detyrimin të analizojë dhe evidentojë saktë marrëdhënien juridike që lidh subjektin e rivlerësimit me pasurinë në përdorim, në drejtim të verifikimit të çdo fakti apo rrethane që mund të ngrejë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurive në përdorim të tij, që mund të rezultojnë të jenë krijuar nga vetë subjekti i rivlerësimit... [...].*

II. Për sa i përket kriterit të kontrollit të aftësive profesionale

4. Për vlerësimin e këtij kriteri, Komisioneri Publik, nëpërmjet shkaqeve të ankimit, kërkoi nga Kolegji, që në kuadër të juridiksionit të tij kontrollues dhe rivlerësues, të marrë në analizë dhe të vlerësojë bazueshmërinë e përfundimit të arritur nga Komisioni për këtë kriter, bazuar në provat dhe aktet e administruara, duke çmuar mendimin dhe dy gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, në cilësinë e provës që dëshmon faktin, rrethanën apo standardin ligjor të parashtruar në të.

4.1 Duke i bërë pjesë të shkaqeve të ankimit, Komisioneri Publik vlerësoi se *mendimi* dhe *dy gjetjet* e vëzhguesit ndërkombëtar do duhet të vlerësohen për qëllim të procesit të rivlerësimit nga ana e Kolegjit, duke mbajtur në konsideratë edhe praktikën e tij të mëparshme lidhur me zbatimin e nenit 59/4 të ligjit nr. 84/2016, si për shembull, vendimi orientues (JR) nr. 2/2020.

4.2 Subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit gjyqësor, prapësoi dhe kundërshtoi këtë shkak ankimi, duke kërkuar mosmarrjen parasysh të tyre nga ana e Kolegjit, në kuadër të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, subjekti ka dorëzuar, në cilësinë e provës, vendimin nr. *** prot., datë **.3.2022, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të rastit, të paraqitur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për magjistratin Gerd Hoxha...”. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka arritur në këtë përfundim duke vlerësuar, ndër të tjera, se: “... nga shqyrtimi fillestar rezulton se në rastin konkret janë pretenduar dhe paraqitur fakte të qarta dhe të mjaftueshme, si dhe janë shoqëruar me prova, por të cilat nuk i krijojnë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë një dyshim të arsyeshëm, i cili justifikon fillimin e hetimit disiplinor sipas kërkesave të nenit 122, pika 1, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a”, të Kushtetutës, dhe nenit 101, pika 1, shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016...”.

4.3 Komisioneri Publik çmon se vendimmarrja e këtij organi kushtetues, marrë në zbatim të një kuadri tjetër ligjor, nuk mund të ndikojë apo zëvendësojë juridiksionin rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për qëllim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit 59 të ligjit. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik i qëndron shkaqeve të ankimit për këtë kriter, duke kërkuar vlerësimin e rastit nën optikën e nenit 61/5, të ligjit nr. 84/2016.

III. Kërkimi përfundimtar i ankimit

Duke përfunduar për sa parashtruam, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së, Komisioneri Publik, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 393, datë 3.6.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gerd Hoxha.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO